



## HOLLI HYRËS MULTIFUNKSIONAL

RI-DIZAJNIMI I HOLLIT TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI" NË PRIZREN



## HOLLI HYRËS MULTIFUNKSIONAL

### RI-DIZAJNIMI I HOLLIT TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI" NË PRIZREN

raport i punëtorisë vizionuese

Autorë: Flaka Xërxa Beqiri & Fati Çeku

Ky grant është mundësuar nga 'Programi i shoqërisë civile për Shqipërinë dhe Kosovën', financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF) në partneritet me Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PA). Përbajtja e këtij reporti dhe rekomandimet e dalura nga ky raport nuk paraqesin qëndrimin zyrtar të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë dhe Fondacionit Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)

Dhjetor, 2019

Botues: EC Ma Ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci, Nr.94, Prizren

Bulevardi Nënë Tereza, H 30 B1 Nr.5, 10000 / Prishtinë

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) & [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)

029 - 222 - 771 & 038 - 224 - 967

## PËRMBAJTA

1. HYRJE
2. KONCEPTI I HAPËSIRAVE MULTIFUNKSIONALE NË KUADËR TË OBJEKTEVE SHKOLLORE DHE RËNDËSIA E TRAJTIMIT TË TYRE
3. METODOLOGJA E PUNËTORISË VIZIONUESE PËR RI-DIZAJNIMIN E HOLLIT HYRËS TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"
4. IDENTIFIKIMI I MANGËSIVE TË GJENDJES EKZISTUESE TË HOLLIT HYRËS TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"
5. PROPOZIMET NË RI-DIZAJNIMIN E HAPËSIRËS MULTIFUNKSIONALE NË KUADËR TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"
6. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME



## 1. HYRJE

Koncepti i edukimit ka pësuar evoluim sa i takon kurrikulave mësimore dhe asaj që konsiderohet nevojë bazë. Tendenca për t'i ikur mësimit klasik dhe për të përqafuar metodologji më bashkëkohore të të nxenit, është e pranishme edhe në shkollat e vendit tonë. Megjithatë, infrastruktura është ajo që vazhdon të trashëgohet nga sistemi klasik, duke ndikuar jo pak në ngecjen e aplikimit të reformave në edukim.

Në Kosovë objektet shkolllore ekzistuese, edhe pse të ndërtuara në periudha kohore të ndryshme, janë kryesisht të konceptuara sipas sistemit tradicional të edukimit, ku njësia bazë përbën një klasë drejtkëndëshe me mësuesin/arsimtarin në pozitë dominante, dhe nxenësit të rreshtuar në gjysmën e mbetur të klasës. Mirëpo sot, me aplikimin e tendecave më bashkëkohore në kuadër të kurrikulave mësimore, parashihet një interaksion më i madh në mes të nxenësve, ku nxenësi më nuk ka pozitë pasive në kuadër të procesit mësimor, por e kundërt, e udhëheq atë duke aplikuar edhe metodologji më jo-formale në krahasim me sistemin klasik.

Rrjedhimisht, risitë në konceptet e edukimit detyrimisht kërkojnë modifikimin e hapësirave klasike në kuadër të shkoll-

-ave ekzistuese, duke kërkuar më shumë fleksibilitet dhe mundësi të shtimit të përbajtjeve të cilat dikur nuk janë parë të nevojshme të janë pjesë e objekteve shkolllore. Të tillë janë hapësirat multifunksionale në kuadër të shkollave të ciklit të ulët dhe të mesëm, të cilat tejkalojnë konceptin e një holli hyrës klasik që nxenësit e kanë shfrytëzuar në të kaluarën vetëm në trajtën e hapësirës komunikuese për të shkuar nga njëra klasë në tjetrën. Sot hollet hyrëse në kuadër të objekteve shkolllore kryejnë edhe funksione të tjera, në favor të aktiviteteve të lira të parapara më kurrikulat mësimore bashkëkohore.

Ky raport shpalos trajtimin e hollit hyrës të Shkollës së Mesme të Mjeksisë "Luciano Motroni" në Prizren si rast studimi se si një hapësirë e pashfrytëzuar mund të ri-dizajnohet në një hapësirë multifunksionale. Si i tillë, ky raport vë në pah mundësinë e kthimit të hapësirës së njejtë në një vend më të këndshëm për të qëndruar, përmes konceptit të qëndrueshmërisë dhe reciklimit të materialeve.

## **2. KONCEPTI I HAPËSIRAVE MULTIFUNKSIONALE NË KUADËR TË OBJEKTEVE SHKOLLORE DHE RËNDËSIA E TRAJTIMIT TË TYRE**

Inkorporimi i hapësirave për shumë qëllime në kuadër të objekteve shkollore të ciklit të ulët dhe të mesëm paraqet një tendencë në rritje në normat më të reja të projektimit. Ekzistimi i një hapësire e cila mund të funksionojë për akomodimin e aktiviteteve dhe nevojave të ndryshme zë vend në priorititet e shkollave bashkëkohore në nivel ndërkombëtar.

### **Çka paraqet hapësira multifunksionale në kuadër të objekteve shkollore?**

Hapësira multifunksionale në kuadër të një objekti shkollor jep mundësi të shumfishta për shfrytëzuesit potencial, përfshirë këtu nxënësit, stafin e mësimdhënësve por edhe komunitetin, të shfrytëzimit të një hapësirë për kryerjen e shumë funksioneve. Duke u përshtatur me risitë në kurrikulat mësimore, një hapësirë e tillë u jep nxënësve mundësinë që t'i zgjerojnë aktivitetet e tyre jashtë programit mësimor klasik, duke stimuluar zhvillimin e aktiviteteve të lira dhe të qenurit kreativ.

Përderisa në të kaluarën aktivitetet e caktuara në kuadër të objekteve shkollore parashiheshin në mënyrë strikte të ndara nga njëra tjetra, duke krijuar hapësira të veçanta për mësim, hapësira të veçanta për organizimin e eveneve, të tjera të veçanta për sport (siç ishte salla e edukatës fizike) etj, sot ekonomizimi i shumë hapësirave të veçanta në një hapësirë të vetme, siç është hapësira multifunksionale, përbën çelsin e një projektimi të suksesshëm të objekteve shkollore. Në një hapësirë të tillë nxënës, apo grupe nxenesish që më parë kanë zhvilluar aktivitetin mësimor vetëm në kuadër të klasës së tyre, mendohet të kenë mundësinë që të qëndrojnë dhe të zhvillojnë mësimin jo formal edhe në kuadër të hapësirës për shumë qëllime, hapësirë kjo e cila në raste të caktuara mund të adaptohet në sallë për organizim e eveneve të ndryshme të hapura për komunitetin, ushtrimin e aktiviteteve rekreative dhe sportive, mundësinë për të drekuar apo pirë një kafe apo mundësinë për të vazhduar aktivitetin mësimor në hapësirën e jashtme e cila rëndom është e lidhur me hapësirën për shumë qëllime. Të gjitha këto mundësi në një hapësirë të vetme e cila për nga përbajtja e mobiliarit mendohet të jetë krejtësisht fleksibile, me mundësi për tu adaptuar varësisht nga nevojat dhe kërkesat e shfrytëzuesve, rrjedhimisht nxënësve.



*Fig.1. Hapësirë me mundësi shfrytëzimi të shumëfishtë. Los Pilares School / Dovat Arquitectos, Uruguai*

### Cila është rëndësia e hapësirave multifunksionale?


Objektet shkollore me sistemin klasik të organizimit funksional konsiderohet të kenë shumë hapësira të cilat në pjesën më të madhe të ditës mbeten të pashfrytëzuara, ndonëse mirëmbajtja e tyre i kushton menaxhmentit të shkollës. Sallat e sportit, sallat koncertale, sallat për punë në grupe apo hapësirat për aktivitete të tjera të profilizuara, ofrojnë mundësinë që të shfrytëzohen vetëm për një periudhe të

caktuar të ditës sa është edhe kohëzgjatja e vet aktiviteteve, ndërsa pjesën tjetër të ditës mbeten të zbrazta. Në periudhën që nuk shfrytëzohen, ato sërisht shfrytëzojnë resurse sikurse energjia elektrike dhe ngrohja dhe klimatizimi. Rrjedhimisht, planifikimi i një hapësire multifunksionale e cila do t'i akomodonte të gjitha aktivitetet e curriculave mësimore në një vend të vetëm, është tëjet i rëndësishëm sa i përket planifikimit të qëndrueshëm.

Në anën tjetër prania e holleve dhe korridoreve pa përbajtje të caktuar stimulon kalimine shpejtë të tyre, vetëm si formë e



*Fig.2. Hapësira multifunksionale me bibliotekë të integruar. Qianhai NO.3 Primary School / Yuansim Architects, Kinë*



*Fig.3. Vende të punës në kuadër të hapësirës multifunksionale. Common Ground High School / Gray Organschi Architects, USA*

komunikimit horizontal, pa stimuluar interaksion në mes të nxënësve, mësimdhënësve apo edhe komunitetit. Si të tilla këto hapësira konceptohen vetëm si utilitare, dhe nuk krijojnë ndjenjën e afërsisë te përdoruesit primar, e që janë nxënësit.

Hapësira për shumë qëllime, apo hapësira multifunksionale ofron bashkëdizimin e këtyre dy përbajtjeve dhe nevojave në një hapësirë të vetme me qëllim të ofrimit të mundësive për zhvillimin e shumë aktiviteteve brenda dhe jasht kurrikulare në një hapësirë të vetme, e cila për nga dizajni stimulon te nxenesit të qenurit sa më kreativ. Aplikimi i materialeve moderne dhe dizajnimi i hapërisave modulare për ulje mundëson shfrytëzimin e hapësirës për shumë qëllime edhe në mënyre jo-formale, për socializim, punë në grupe dhe aktivitete te tjera të dalura nga vetë kërkkesat e nxënësve.



*Fig.4. Mundësi për aktivitete të lira në kuadër të hapësirave komunikuese. Primary School in Basel / ZMIK Architects, Zvicër*




Fig.5. Përfshirja e sallës së sporteve në kuadër të hapësirës multifunksionale. Ecole Supérieure des Arts du Cirque/ Daniel Delgoffe, Belgjikë



Fig.6. Ndërlidhja e hapësirës multifunksionale me hapësirat e jashtme. School René Beauverie / Dominique Coulon & associés , France

### Hapësira multifunksionale - si definohet?!

Hapësira për qëllime të shumëfishta definohet si koncept edhe në legjislaturën e Republikës së Kosovës. "Udhëzuesi për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore", zyrtarizuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë, e përcakton hapësirën për shumë qëllime si kthinë të veçant funksionale në kuadër të objekteve shkollore duke definuar në mënyrë specifike parametrat të cilat duhet të mirren parasysh në momentin e projektimit të objekteve shkollore.

---

## **HAPËSIRA (SALLA) PËR QËLLIME TË SHUMËFISHTA SHËRBEN PËR MBAJTJEN E AKTIVITETEVE TË PARAPARA ME KURRIKULUM DHE PËR AKTIVITETE REKREATIVE DHE LUAN ROL QËNDROR PËR TAKIME TË SHKOLLËS DHE KOMUNITETIT.**

---

Bazuar në këtë dokument, hapësira për shumë qëllime duhet të ofrojë mundësi në realizimin e këtyre aktivitetave:

- 1.** Organizimet muzikore dhe teatrale, shfaqjen e filmave dhe

kuvendet e përgjithshme të organeve të nxënësve.

**2.** Sportet dhe lojërat që mbahen kryesisht në kohë të dimrit, ekspozitat, mësimdhëniet në punëtori.

**3.** Takimet e komunitetit lokal, prezantimet, interpretimet dhe takimet për shoqatat e prindërve dhe të mësimdhënësve

"Udhëzuesi për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore" definon poashtu këto elemente sa i takon projektimit dhe kushteve teknike të projektimit të hapësirave (sallave) për shumë qëllime:

**KAPACITETI DHE SIPËRFAQJA:** Sipërfaqja është llogaritur në proporcionin prej  $0.50 \text{ m}^2$  për nxënës, për tërë kapacitetin e shkollës, duke pasur parasysh se numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të shkollës do të mblidhet njëherë ose dy herë në vit.

**ANEKSET:** Salla për shumë qëllime mund të ketë anekset siç janë kuzhina, salla për përgatitjen e arsimtarëve me dollapë dhe tualete, depo, holl (në hyrjen kryesore), korridorin hyrës, galeri për spektatorë, etj.

**FLEKSIBILITETI:** Plani duhet të jetë shumë fleksibil dhe të mundësojë përshtatjen për disa veprimitari të ndryshme të




Fig.8. Skema e organizimit të hapësirës për shumë qëllime sipas "Udhëzuesit për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore"/ MASHT

cilat mund të mbahen në të njëjtën kohë apo njëra pas tjetrës. Struktura duhet të projektohet në atë mënyrë që të mos nevojitet asnjë shtyllë në mes të kësaj hapësire, ndërsa tavani duhet të jetë mjaft i lartë për të mundësuar lojërat dhe aktivitete tw ndryshme.

**PAJISJET:** Pajisjet e fiksuar duhet të shmanget sa më shumë

që të jetë e mundur. Skena për shfaqje teatrale duhet të jetë prej njësive të vogla të platformës të cilat mund të rirregullohen nga nxënësit për t'u përdorur për veprimtari të tjera. Paisje të nevojshme konsiderohen: sistemi i zërimit; pajisjet audiovizuale dhe ekranit; tabelat e bardha; tapetat për gjimnastikë dhe pajisjet e tjera sportive.

**AKUSTIKA:** Shumë prej aktivitetave që mbahen në sallën për qëllime të shumëfishta janë të zhurmshme, andaj hapësira duhet të ketë izolim të mirë të zërit dhe duhet t'i posedojë masat e zvogëlimit të jehonës.

**NDRIÇIMI:** Salla duhet të ofrojë mundësinë e errësimit për disa veprimtari të caktuara siç janë produksionet e filmave, shfaqjet teatrale, etj.

**AJROSJA:** Ajrosja e vazhdueshme së bashku me ngrohjen e duhur të sallës janë thelbësore.

**DYSHEMETË:** Rekomandohen shtresa jo të lëmueshme dhe jo të rrëshqitshme.

**MURET:** Lloje të ndryshme të shtresave të sipërme për variacione akustike, pra pllaka gipsi të ngjyrosur, panelet prej

druri, rripat prej druri me absorbim akustik, shpërplakë.

**TAVANET:** Forma dhe punët përfundimtare të tyre duhet të kenë efektin e dëshirueshëm akustik, pra pllaka gipsi të ngjyrosur, pllaka akustike, rripa prej druri me absorbim akustik, shpërplakë.

**NGJYRA:** Ngjyra të ngrohta apo neutrale dhe materiale natyrale me pëlhura të ndritshme dhe murale.

**ORENDITË DHE PAJISJET:** Nevojat për sa i përket orendive mund të ndikohen nga llojallojshmëria e funksioneve. Kjo përfshinë: karrige komfore të veshura me susta dhe të palosshme me njëra tjetrën dhe skena të bëra nga kutitë apo platformat modulare për të mundësuar fleksibilitet.

### **3. METODOLOGJIA E PUNËTORISË VIZIONUESE PËR RIDIZAJNIMIN E HOLLIT HYRËS TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"**

Punëtoria vizionuese për ri-dizajnimin e hollit të shkollës "Luciano Motroni" është realizuar në kuadër të projektit "Eko Shkolla" më 01 tetor 2019. Metodologjia e punëtorisë është e bazuar në planifikimin me pjesëmarrje, ku përmes përfshirjes aktive të nxënësve të kësaj shkolle, është bërë shqyrtimi I mangësive dhe përparrësive të gjendjes ekzistuese dhe është ideuar projekt propozimi për intervenimin në gjendjen ekzistuese, me qëllim të funksionalizimit të saj.

Ideja për realizimin e kësaj punëtorie konsiston në faktin se kjo shkollë edhe pse e ndërtuar në dekadën e fundit dhe e paisur me hapësirën për shumë qëllime, tregon ngecje sa i përket funksionalizimit të saj. Aktualisht hapësira në fjalë rrezulton të jetë e pashfrytëzuar për destinimin fillesttar të saj (hapësirë për shumë qëllime e definuar sipas udhëzuesit të MASHT) duke dhënë përshtypjen e një hapësirë të zbratët dhe jo-ftuese për nxënësit.

Punëtoria është organizuar me qëllim që të rinjve t'u krijojë mundësinë të shprehin vizionin e tyre për hapësirën të cilën e frekuentojnë çdo ditë, duke i bërë kështu pjesëmarrës në



*Fig.9. Pamje nga sesioni i parë i punëtorisë "Informata mbi konceptet e hapësirave multifunksionale"*



*Fig.10. Puna grupore gjatë analizës së gjendjes ekzistuese*

procesin e planifikimit të hapësirës së shkollës së tyre dhe duke u dhënë mundësinë që ta ri-dizajnojnë në një hapësirë multifunksionale bazuar në nevojat e tyre. Për fokus të kësaj punëtoria, përshtatur me konceptin e projektit "Eko Shkolla" ka qenë aplikimi i arkitekturës së qëndrueshme dhe materialeve të re-ciklueshme.

Punëtoria është zhvilluar me pjesëmarrjen aktive të nxënësve përfaqësues të shkollës "Luciano Motroni" dhe "Grupit të Ekologëve" me shtrirje në tri sesione:

### **1. INFORMATA MBI KONCEPTET E HAPËSIRAVE MULTIFUNKSIONALE**

Gjatë këtij sesioni nga ana e fasilitatorëve të punëtorisë është bërë prezentimi i rasteve studimore në botë lidhur me trajtimin e hapësirave multifunksionale në konceptet bashkëkohore të projektimit. Ky session ka patur për qëllim informimin e përgjithshme të nxënësve lidhur me konceptet e hapësirave multifunksionale dhe përbajtjet që zakonisht këto hapësira ndërthurin në vete

### **2. PYETËSORI MBI GJENDJEN EKZISTUESE**

Ky sesion ka shërbyer për plotësimin e pyetësorit mbi gjendjen ekzistuese të hollit hyrës të shkollës "Luciano Motroni" ku

nxënësit janë pyetur mbi faktin se a e shfrytëzojnë këtë hapësirë; cilat janë arsyet të cilat pamundësojnë shfrytëzimin e saj; sa është koha e shfrytëzimit në rastet kur ajo shfrytëzohet; cilat janë përbajtjet të cilat I mungojnë kësaj hapësire dhe cilat ata do të dëshironin t'i shtonin etj. Ky sesion ka patur për qëllim konceptimin e gjendjes aktuale në hapësirën e trajtuar në këtë punëtori, përmes mbledhjes së pikëvështrimeve të ndryshme nga ana e shfrytëzuesve potencial, në këtë rast nxënësve.

### **3. IDENTIFIKIMI I MANGËSIVE DHE PËRPARËSIVE**

Ky sesion ka konsistuar në identifikimin e mangësive dhe përparësive të hollit hyrës – ekzistues përmës SWOT analizës. Nxënësit dhe përfaqësuesit e Grupit të Ekologëve kanë listuar anët positive të hapësirës në fjalë dhe mundësitë që ajo ka për një organizim multiunkional, duke identifikuar njëkohësisht elementet të cilat ata i kanë konsideruar si të mangëta dhe që ndikojnë negativisht në përfjetimin e kësaj hapësire.

### **4. PROPOZIMET**

Sesioni i fundit ka shërbyer për përfshirjen e nxënësve në fazën e dizajnit të hollit hyrës me qëllim të shëndërrimit të tij në hapësirë multifunksionale. Nxënësit të ndarë në grupe


kanë diskutuar për mënyrat e mënjanimit të mangësive me të cilat aktualisht hapësira përballet dhe për mundësitë e reja në fazën e ri-dizajnimit të saj. Nxënësit, me ndihmën e facilitatorëve të punëtorisë, janë shtyer të propozojnë aktivitete shpeshtë të cilat mund t'i shtohen kësaj hapësire në të ardhmen si dhe kanë diskutuar mundësitë e aplikimit të materialeve të re-ciklueshme në realizimin e ideve të tyre.

#### **4. IDENTIFIKIMI I MANGËSIVE TË GJENDJES EKZISTUESE TË HOLLIT HYRËS TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"**

Faza fillestare për vizionimin e hollit multifunksional në shkollën "Luciano Motroni" ka konsistuar në identifikimin e problematikave përmes pyetësorëve dhe analizës së përparësive dhe mangësive.

Të rindjtë pjesëmarrës janë përgjegjur në masë të madhe se nuk e shfrytëzojnë hapësirën në fjalë, apo se e shfrytëzojnë vetëm për të kaluar shpejtë nga njëra pjesë e korridorit në tjetrën, por pa u ndalur për të qëndruar në të. Të pyetur nëse periudha e shfrytëzimit është vetëm sa për të kaluar në të, apo periudhë prej 5, 10 e më shumë minuta, të anketuarit në shumicë janë përgjegjur se e shfrytëzojne vetëm sa për të shkuar deri në klasën përkatëse, në periudhë më të shkurtë se 5 minutëshe.

Ndërsa arsyet se pse kjo hapësirë nuk shfrytëzohet, përkundër potencialit që ka, të anketuarit kanë listuar disa nga këto: mungesë e aktiviteteve; mungesë e ulëseve; hapësirë jo-atraktive; hapësirë monotone për nga dizajni; mungesë e bibliotekës, byfesë dhe përmrbajtjeve të tjera për shfrytëzim; mungesë e gjelbërimit; mungesë e hijes gjatë periudhës me



*Fig.11. Gjendja ekzistuese e hopësirës së trajtuar në punëtorinë vizionuese*

temperatura të larta etj.

Përkundër problematikave të identifikuara, gjatë sesionit të SWOT analizës, pjesëmarrësit kanë listuar disa nga përparësítë që kjo hapësirë posedon dhe mundësítë që në të ardhmen ajo të shëndërohet në një hapësirë të shfrytëzueshme.

Hapësira është mjaftueshëm mirë e konsoliduar, që don të thon se ofron mundësi që në të akomodohen shumë përbajtje. Këtë e mundëson fillimisht pozita qëndrore në kuadër të objektit shkollor "Luciano Motroni" si dhe poashtu fakti që posedon lartësi të dyfishtë. Edhe pse për nga trajtimi i enterierit, rrjedhimisht materializimi, ajo momentaisht paraqet një hapësirë jo-ftuese, vlen të theksohet se pikërisht projektimi i saj në bazë të parametrave të kërkuar me udhëzuesin në fuqi (pozita e mirë, sipërfaqja e mjaftueshme, ndërlidhja me ambientin e jashtëm, lartësia adekuate etj.), ofron mundësi që në të ardhmen e njejtë adaptohet dhe të mund të shfrytëzohet si hapësirë multifunksionale.

Gjatë punëtorisë pjesëmarrësit kanë propozuar që disa nga aktivitetet që do të mund të zhvillohen në të përfshijnë: kalimin e kohës së lirë nga ana e nxënësve, leximin, mësimin jo-formal, punën në grupe, shfytëzimin e paisjeve elektronike

(me theks në laptop), organizimin e eventeve të ndryshme (me theks në përformancat artistike), socializimin me të tjera etj.

Sipas vlerësimit të përgjithshëm të nxënësve, elementet dhe intervenimet e mëposhtme do të mund të përmirësonin situatën aktuale në hollin hyrës të shkollës: insertimi i hapësirave për ulje, shtimi i hapësirave gjelbëruese, aplikimi i ngjyrave dhe mënjanimi i atmosferës monokromatike, dizajnimi i hapësirave për mësim jo-formal dhe punë në grupe, dizajnimi i hapësirave për socializim, mvesha e shkallëve me materiale të ngrrohta dhe mundësia e shfrytëzimit të tyre për ulje, insertimi i një skene për performanca të ndryshme publike dhe organizim të eventeve.

Ndër kërkesat më specifike të tyre përfshin ideimi i një këndi i cili do të mund të shfrytëzohej nga ana e Klubit të Ekologëve për takimet e tyre të rregullta e të cilat momentalisht nuk mund të realizohen në asnjerën hapësirë të shkollës.

## 5. PROPOZIMET NË RI-DIZAJNIMIN E HAPËSIRËS MULTIFUNKSIONALE NË KUADËR TË SHKOLLËS "LUCIANO MOTRONI"

Zgjidhja e ofruar për ri-dizajnimin e hollit ekzistues të objektit shkollor "Luciano Motroni" është tërësisht e bazuar në fazat paraprake të punëtorisë vizionuese. Bazuar në përkесat e pjesëmarrësve të puëntroisë, janë shqyrtuar mundësitë e shëndërrimit të saj në hapësirë multifunksionale, gjithnjë duke patur për bazë një dizajn të qëndrueshëm. Poashtu propozimi për ri-dizajnimin e hollit është bazuar tërësisht në parametrat e 'Udhëzuesit për Normat dhe Standardet e Ndërtesave Shkollore' të Ministrisë për Arsim, Shkencë dhe e Teknologji.

Propozimi në fjalë është një tentativë për të vënë në funksion hapësirën ekzistuese e cila nga nxënësit është cilësuar si e pa shfrytëzuar për faktin se paraqet një hapësirë të zbrazët, pa përbajtje, pa mobiliar adekuat dhe rrjedhimisht për ta paraqet një hapësirë jo-atraktive. Për ta funksionalizuar atë, ky propozim ka për koncept dizajnimin e shumë këndeve funksionale të përfshira në një hapësirë të vetme të cilat do të mundësonin që grupe të ndryshme të nxënësve të mund ta shfrytëzonin atë varësisht nga preferencat e tyre dhe në



PËRDORIM I PAISJEVE ELEKTRONIKE  
MUNGESË E NJË BIBLIOTEKE TË HAPUR



MUNGESË  
E ULËSEVE  
PËR  
NXËNES



MUNGESË E  
HAPËSIRËS  
PËR  
ORGANIZIME  
ARTISTIKE



PUNË GRUPORE



MUNGESË E  
HAPËSIRAVE  
PËR PUNË  
GRUPORE



MATERIALE TË RECIKLUESHME

MËSIM JO-FORMAL



QËNDRIMI I LIRË



MUNGESË E  
HAPËSIRAVE PËR  
SOCALIZIM  
GJELBËRIM

MONOTONI



SOCALIZIM



ORGANIZIME TË NDRYSHME

intervale kohore të përshtatshme për ta. Në këtë mënyrë e njejtë hapësirë do të ishte e frekuentuar përgjatë gjithë ditës.

Rrjedhimisht janë dhënë tri skenarë të organizimit të cilët dëshmojnë se e njëjtë hapësirë mund të funksionalizohet për funksione të ndryshme, varësisht nga kërkësat dhe nevojat e nxënësve, menaxhmentit të shkollës apo edhe komunitetit. Këtë e mundëson veçanërisht mobiliari modular, i cili mundëson që lehtësisht hapësira të modifikohet dhe sërisht të kthehet në gjendjen paraprake. Ky lloj i dizajnit është paraparë të aplikohet në të gjitha pjesët e mobiliarit të propozuara, që nga skena, ulëet, saksitë për lule etj, duke arritur në këtë mënyrë një dizajn të qëndrueshëm. Poashtu propozimi ka patur për qëllim përdorimin sa më të madh të materialeve të reciklueshme, me qëllim të theksimit të rëndësisë së këtij procesi dhe mbrojtjes së ambientit në përgjithësi.

Propozimi përfshinë fillimisht aplikimin e ngjyrave në një mjedis pothuajse monokromatik që aktualisht mbizotëron në te. Kjo nënkupton, bazuar në kërkësat e nxënësve, arritjen e një atmosfere më të ngrrohtë për ta si dhe mundësinë që periudha e qëndrimit aty të rritet. Si kërkësë tjetër qëndrore ka dalë të jetë mungesa e vendeve për ulje, të cilat do tu ofronin mundësinë nxënësve që të qëndrojnë, punojnë dhe

diskutojnë mes tyre. Rrjedhimisht ky vizionim propozon që të shtohen në masë të madhe vende për ulje përmes ulëseve modulare si dhe përmes mveshjes së shkallëve rrethuese të hapësirës me material druri të recikluar. Ulëset modulare janë menduar poashtu të jenë të mveshura me materiale të reciklueshme, ndërsa hapësira në tërësi është menduar që të gjelbërohet me shtimin e drunjëve dekorativ dhe reciklimin e shishevë të plastikës dhe kthimit të tyre në saksi lulesh sezionale. Ajo që është më e rënsësishme është se ky vizionim propozon që hapësirës t'i shtohen disa përbajtje funksionale njëkohësisht.

**QËNDRIMI I LIRË** - Shtuarja e vendeve për ulje mundëson shfrytëzimin e kësaj hapësirë për qëndrim të lirë, socializim me të tjerë dhe pikë takimi me komunitetin

**PUNA NË GRUPE** - Shtuarja e vendeve (mobile) të punës mundëson që nxënësit ta shfrytëzojnë këtë hapësirë për punë në grupe, mësim jo-formal dhe hulumtim

**PERFORMANCAT ARTISTIKE** - Propozimi i një skene mobile dhe përshtatja e ulëseve modulare në formë auditoriumi mundëson zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme sipas nevojës

**BIBLOTEKA E HAPUR** - Ofrimi i një fondi doracak të librave nga biblioteka ekzistuese do të mundësonë që nxënësit ta shfrytëzonin këtë hapësirë edhe për lexim.

**KTHIMI I SHKALLËVE NË VENDE PËR ULJE**

**SHTUARJA E SKENËS MODULARE**

**APLIKIMI I ULËSEVE MODULARE**

**APLIKIMI I NGJYRAVE NË MURE**

**APLIKIMI I DEKORIMEVE NGA M. E RECIKLUARA**


**INSERTIMI I HAPËSIRAVE GJELBËRUASE**

**SHTUARJA E BIBLIOTEKËS DORACAKE**


**APLIKIMI I NDRIÇIMIT NGA M. E RECIKLUARA**

**MVESHJA E SHKALLËVE ME DRU TË RECIKLUAR**


**KONCEPTI:** Mundëson shfrytëzimin e hapësirës multifunksionale përfunksione të ndryshme, përfshirë uljen në hapësirën e shkallarëve me qëllim të qëndrimit dhe zhvillimit të mësimeve jo-formale; qëndrimin dhe socializimin përreth ulëseve modulare; punën grupore pranë tavolinave të përshtatshme për shfrytëzimin e paisjeve elektronike, zhvillimin e performancave artistike si dhe aktiviteteve të tjera.




# SKENARI 1




## SKENARI 2



# SKENARI 3














				ulëse modulare konstruktioni druri i ricikluar - mbëshqetje stungjës druri i ricikluar - 84 copa
				saksi - MDF i ngjyrasur - 3 copa
				tavolinë pune gjysmërrethore - MDF i ngjyrasur bardhë - 6 copa
				tavolinë pune gjysmërrethore - MDF i ngjyrasur bardhë - 4 copa
				* raft për libra - MDF - 4 copa
	paleta për mbëshqetjen e shkallëve rreth hollit ~ 100 m² ~ 100 copa	—		paleta për përdorim si tavolina në katin e parë 16 copa
	gjelbrim vertikal në sheshet e ricikluara 70 copa	—		gjelbrim vertikal i varur ne rrethojat e shkolles
RAL 250-3	RAL 3015	RAL 3035	RAL 1018	paleta e ngjyrave + ngjyra e bardhë + ngjyrë të kuge përrrethojat e hekurit
				* shembuj te ndrysimit me materialë te ricikluara

## 6. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME

Ky vizonim ka patur për synim adaptimin e një hapësire ekzistuese të shkollës përfituese të projektit "EKO Shkolla" me qëllim të funksionalizimit të saj dhe aplikimit të një dizajni të qëndrueshëm. Ky qëllim komplementohet me faktin se shumica e shkollave ekzistuese në Komunën e Prizrenit kanë nevojë për intervenime të ngashme me qëllim të adaptimit të tyre për sistemet bashkëkohore të edukimit.

Në rastin konkret kemi të bëjmë me një objekt shkollor i cili edhe pse e posedon hapësirën (sallën) për shumë qëllime, ajo nuk shfrytëzohet. EC ka përdorur metodologjinë e planifikimit me pjesëmarrje për te identifikuar problematikat që kjo hapësirë i ka, duke marrë për bazë kërkesat e nxënësve.

Ky përbën vetëm një shembull se si përmes përfshirjes së nxënësve mund të vihet deri te propozimet konkrete për adaptimin e hapësirave të pa shfrytëzuara dhe shëndërrimit të tyre në mjedise edukative dhe rekreative për shfrytëzuesit potencial (nxënësit, mësimdhënësit, komunitetin) përmes dizajnit të qëndrueshë.

EC rekomandon që të bëhet një studim në nivel të Komunës

së Prizrenit për të gjitha objektet shkollore ekzistuese dhe hapësirat me potential që ato posedojne. Përmes këtij studimi do të identifikoheshin mundësítë për intervenime në të ardhmen, me qëllim të adaptimit të këtyre hapësirave përmes dizajnit të qëndrueshëm. Një intervenim i tillë do të mundësonë siguri min e infrastrukturës bazë konform ndryshimeve kurrikulare të cilat sistemi i edukimit eshtë duke tentuar t'i aplikojë.

Përpos tjerash, intervenime të tillë do të mundësonin në edukimin e të rinjëve për aktivizmin mjedorës komunitetit dhe mundësisë së aplikimit të materialeve të reciklueshme si pjesë e dizajnit.

[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org)